

PROCES-VERBAL

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Kurbin

Data: 03.11.2025 **Ora:** 11:00

Vendi: Bashkia Kurbin

Drejtuese: Edlira Lleshi – Kryetare e Këshillit Bashkiak

Rendi i Ditës

1. Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% për muajin shtator 2025.
 2. Projekt-vendim për miratimin e një ndryshimi në V.K.B. nr. 63, datë 22.04.2020, “Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave publike dhe private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në akt-ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë.”
 3. Projekt-vendim për miratimin e përforcimit dhe ndërhyrjeve të nevojshme në pallatin nr. 84, lagjja nr. 3, Laç, të prekur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në projektin e përforcimit, oponencën teknike dhe shkresën e ardhur nga Instituti i Ndërtimit.
 4. Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave për dëmet e shkaktuara në banesën e familjes Tafili, Njësia Administrative Milot, fshati Shullaz, si pasojë e plasjes së bombulës së gazit.
 5. Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave për dëmet e shkaktuara në murin mbajtës afër banesës së familjes Gjergji, Njësia Administrative Laç – Sanxhak.
 6. Projekt-vendim për miratimin e tarifave të ujit të pijshëm, grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura.
 7. Projekt-vendim për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025.
 8. Të ndryshme.
-

Të pranishëm:

22 këshilltarë bashkiakë

Pjesëmarrës nga administrata:

- Eduart Kurti – Nënkyetar i Bashkisë
- Iris Tahiraj – Drejtore e DPKZHT
- Roland Vathi – Jurist, DPKZHT
- Altin Marashi – Inxhinier, DPKZHT
- Kristina Gjoka – Inxhinier, DPKZHT
- Sabrina Mara – Inxhinier, DPKZHT
- Jonida Merlika – Inxhinier, DPKZHT

- Aldo Jahja – Inxhinier, DPKZHT
- Rake Kola – Drejtoria e Financave
- Llesh Ndoci – Drejtoria e Ndhmës Ekonomike

Miratimi i Rendit tw Ditws

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit:

Fillojmë mbledhjen duke vënë re numrin e këshilltarëve të pranishëm. Me rendin e ditës, besoj jeni njohur? A jeni dakord me rendin e ditës? Po, Diogjen Kolici, ke diçka për të shtuar?

Diogjen Kolici: Po, faleminderit zonja kryetare. Unë do të doja që, me lejen tuaj dhe me miratimin e kolegëve, pasi të ezaurohet i gjithë rendi i ditës, të bëja një propozim për një politikë ekonomike dhe sociale që besoj shumë e nevojshme për bashkinë tonë. E ndjej të nevojshme ta prezantojmë sot, që nëse marrim pëlqimin e kolegëve këshilltarë dhe edhe një opinion nga bashkia, atëherë ta sjellim herën tjetër me shkrim. Duke qenë se jemi një muaj para paketës fiskale dhe buxhetit.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Tani, ti thjesht do të diskutosh në vija të përgjithshme?

Diogjen Kolici: Po, vetëm për diskutim në vija të përgjithshme. Të marrim opinionin e këshilltarëve, por edhe të bashkisë.

Edlira Lleshi: Kush është dakord ta fusim në rendin e ditës kërkesën e Diogjenit? Kush është dakord?
(Miratohet – të gjithë këshilltarët dakord.)

Diogjen Kolici: Faleminderit.

Albert Ndoci: Nuk mund ta miratojmë sot nëse nuk e shohim me shkrim.

Edlira Lleshi: Ka të drejtë Alberti, por nuk është për miratim sot.

Diogjen Kolici: Nuk është për miratim sot, prandaj s'ka nevojë për letër sot. Okej, do ta sjellim në letër, pa merak.

Pika e parë: ndihma ekonomike 6% për muajin shtator 2025

Edlira Lleshi: Në rregull. Atëherë fillojmë me pikën e parë: ndihma ekonomike 6% për muajin shtator 2025. Drejtori, ndonjë gjë e përgjithshme? A ka nevojë për diskutim apo ta kalojmë direkt në votim?

Po, Aida, ke fjalën.

Aida Skeja: Unë mendoj që ndihmën ekonomike ta kalojmë direkt, pa diskutim.

Edlira Lleshi: Po, meqë edhe është vonuar, nuk është normale.

Aida Skeja: Është vonuar dhe njerëzit kanë nevojë, prandaj mendoj ta hedhim në votim.

Edlira Lleshi: E hedhim në votim.

*(Kundër: 0 Abstenim: 0 Pro: të gjithë këshilltarët.)
Miratohet ndihma ekonomike 6% për muajin shtator 2025.*

Pika e Dytë: Projekt-vendim për Miratimin e Përforcimit dhe Ndërhyrjeve të Nevojshme të Pallatit Nr. 84, Lagjia 3 Laç, Prekur nga Tërmeti i Datës 26 Nëntor 2019

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Për urbanistikën, të bëhet relatimi i projekt-vendimit nga zoti Altin Marashi, inxhinier.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Përshëndetje të gjithëve. Atëherë, [kemi] një ndryshim në vendimin numër 68, datë 22.04.2020, për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave pronë publike dhe pronë private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në akt-ekspertizën e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë. Pastaj kemi dhe projekt-vendimin për miratimin e përforcimit dhe ndërhyrjeve të nevojshme të pallatit numër 84, lagjia 3 Laç, prekur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në projektin e përforcimit, oponencës teknike dhe shkresës së ardhur nga Instituti i Ndërtimit. Atëherë, siç e dini, për pallatin 84 u mor një vendim i formës së prerë nga Gjykata e Apelit, e cila detyron që të bëhet një projekt i detajuar për përforcimin e tij. Dhe nëse vlera, sipas Aktit Normativ numër 9, e projektit e tejkalon 70%, i bie që ky të shembet. Nëse është më pak se 70%, i bie që të përforcohet, se nuk paraqet rrezikshmëri. Vlera e këtij projekti, hartuar nga Instituti në Tiranë (i detyruar nga vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit), bazuar në llogaritjet që janë bërë nga ne, por edhe duke bërë një shkresë për interpretim në Institut, rezulton të jetë më e vogël se 70%, dhe sipas Aktit Normativ, i bie që të jetë për rikonstrukcion. Po, po, patjetër. Keni shumë të drejtë.

Eri Zymaj (Këshilltar): Kush e mori vendimin për ta prishur? Nga gjashtë vjet, ato sikur janë hapur dhe meqenë krejt në rregull, janë dëmtuar.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Atëherë, pyetja e parë: Është marrë vendimi për t'u prishur? Është marrë vendimi për t'u prishur. Ka ndjekur një procedurë e cila ka qenë standard në kushtet e emergjencës. U bë një akt konstatimi, dhe ky akt konstatimi u dorëzua në... Ka qenë në shtabin e përgjithshëm me të drejtën e Institutit të Projektimit, dhe Instituti i Projektimit sjell inxhinierët në objekt për ta verifikuar. Puna e bërë, domethënë pa ndonjë laborator, pa ndonjë kështu, por një analizë e thelluar, domethënë jo llogaritje se sa shkon vlera, por analiza e thelluar, e vlerësoi që duhet të shembet. Domethënë jo në detaje të imta komplet; kështu ka qenë procedura. Edhe është marrë vendimi për t'u shembur. Pasi kaloi në Gjykatë ky rast, Gjykata tha: "Duhet të vlerësojmë më tepër këtë objekt dhe ta bëjmë një studio projektimi ndër më të mirat,

nga kriteret e vendosura të tenderit, që ta vlerësojë këtë objekt, a rri në këmbë, a ka nevojë, a e tejkalon 70% apo s'e tejkalon 70%?"

Ded Ndreca (Këshilltar): Jo, e vendos... Kush e vendosi?

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Jo, e vendos studio projektimi, në kuptimin se asaj i del kostoja komplet.

Albert Ndoci (Këshilltar): Në radhë të parë duhet ta di se kush e ka bërë ankimimin, e kanë bërë banorët, apo mos e kanë bërë persona ata... domethënë. Aty, unë me dijeninë time, janë 60 familje që jetojnë në atë pallat. Dhe që të ankohesh aty, të paktën duhet të jenë 70% ose 80% e familjeve që të ankohen, që Gjykata të marrë një vendim. Se nuk mund të dalë Gjykata sa do... Ne jena duke i parë vendimet e Gjykatës se si merren. Me dashur ma dënon, janë vendime të dënuar; s'dashur shkon, nuk e dënon. Krejt është thjeshtë. Shumë e rëndësishme kjo: unë dua ta di, e kanë bërë kërkesën banorët totalisht, jo një banor, se dy banorë. A e ka bërë komplet pallati, apo ka bërë një individ ose dy individë? Ju faleminderit.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Që të bëhet padi, Gjykata e vlerëson për ta pranuar apo jo. Kështu që e kanë vlerësuar. Sigurisht janë pjesë, janë banorët që kanë pjesë dhe kërkesën e kanë bërë ata si objekt.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Të lutem, të lutem. Nuk e kemi bashkëbisedim, Albert. Të lutem. Banorëve, të lutem. Banorët, të lutem, zotëri, nuk ke të drejtë me fol pa dhënë lejen. Jo, këtu jemi anëtarë këshilli. Në qoftë se banorët duan të flasim, do të nxjerrin një përfaqësues. Kjo është mbledhje e Këshillit. Të lutem, një përfaqësues ka të drejtë të fjalës një herë, në qoftë se ka diçka. Këtu janë diskutimet e anëtarëve të Këshillit. Tani e ka radhën Laurini. Pas Laurinit, Sefedin Lika. Laurin Sana e ka fjalën.

Laurin Sana (Këshilltar): Faleminderit, zonja kryetare. Të nderuar kolegë këshilltarë, pyetja ime është si rrjedhojë e vendimit të parë për prishje dhe nxjerrjes jashtë të gjithë banorëve (domethënë bëhet fjalë prej 5 vjet e gjysmë, gati 6 vjet nga 2019), këta banorë ku kanë jetuar? Dhe a është dhënë qeraja deri më tani?

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Atëherë, për periudhën e një deri në dy vjet, është dhënë bonus qeraje. Kemi bërë kërkesë te Qeveria, dhe në një moment të caktuar është ndaluar, deri në 2021, pastaj është ndaluar bonus qeraje për të gjithë banorët. Për t'u nxjerrë për jashtë, janë nxjerrë sepse ekspertiza e ka nxjerrë të pabanueshëm atë pallat. Sido që të jetë, sipas ligjit të ndërtimit, do të duhet të dalin për jashtë, nuk duhet të banojnë në atë pallat. Kështu që e kemi vlerësuar që ata mos të jetojnë, ndaj merret një vendim vullnetar që po merret sot.

Laurin Sana (Këshilltar): A ka pasur një përgjegjësi Bashkia për kaq vite që ata nuk kanë jetuar aty? Dhe a është përgjegjësi e Bashkisë për një shpopullim? Se me dijeninë time gjysma ose më shumë kanë ikur nga lagjja komplet, për arsye se nuk e di...

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Nuk është i dhuri ky term. Termi "shpopullim" nuk mund të përdoret. Tërmetin nuk e solli Bashkia; tërmetin e dimë që erdhi nga shkaqe natyrore.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Laurin, mos dalim nga tema, të lutem. Tani po flasim për një pallat konkret.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Për prishjen e shumë pallateve... jeni dëshmitarë që po rindërtohen, përveç këtij pallati që pati probleme me Gjykatën. Dhe të gjithë pallatet e tjera janë duke u rindërtuar, të gjitha banesat e tjera janë duke u rindërtuar dhe janë mbaruar. Pra, nuk është i saktë ai term që përdoret.

Laurin Sana (Këshilltar): Unë gjithashtu lidhur edhe me këtë temë (duke mos dalë jashtë kësaj teme), unë gjatë këtij muaji kam bërë edhe një kërkesë për informacion, siç më keni kërkuar gjithmonë (që më keni thënë: "Bë kërkesë për informacion"), për gjithë shpenzimet e tërmetit 2019, dhe nuk kam asnjë kthim përgjigje. Që më shumë jam dhe këshilltar. Shpenzimet, po, se si janë menaxhuar, domethënë. U bënë 6 vite. Lidhur me këtë temë.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Po, gjatë relatimit nga shefja e financës, duhet të japin informacion të përmbledhur dhe të detajuar. U mor konfirmimi nga shefi i financës, do ta japim përgjigjen për të gjitha detajet.

Laurin Sana (Këshilltar): Dakord? Faleminderit.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Sefedin Lika e ka fjalën.

Sefedin Lika (Këshilltar): Po, faleminderit, kryetare. Atëherë, sa i përket pallatit që është për riparim... Është hera e parë ka 3 vite gati që shohim banorë prezent. Edhe kemi të drejtë t'i pyesim ne si zyrtarë të Këshillit, çfarë halli keni. Edhe për këtë kam kërkuar edhe dëgjesa publike, që të bëhen gjërat transparente, se edhe ne ta dimë çfarë halli kanë ata. Unë shkova i pyeta pa hyrë këtu, në fakt, po gjithsesi. Po, e cekët edhe Berti: është interesi i 2-3 personave me u prishur punë gjithë atyre familjeve. Sepse gjykatat, ne e dimë, ka herë që bëjnë edhe me interesa, pavarësisht se ne nuk jemi gjykatës, ne jemi avokatë të popullit. Jemi në mbrojtje të banorëve. Kështu që unë jam ok me banorët, nuk e di kolegët e mi se si e kanë mendimin, po unë jam pro banorëve. Sepse nuk kam marrë pjesë as me shkuar me e kontrolluar pallatin si është, në komision. Nuk e di, ndoshta kanë të drejtë banorët, kështu që meqë janë më shumë, unë kam qejf të mbështes banorët. Ndoshta jam gabim, po.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): I nderuar këshilltar, ne dhe ne si Bashki jemi pro interesave të banorëve. Ne nuk duhet të bëjmë ndarje, divergjenca me banorët, kundër banorëve. Të gjithë këtu jemi në shërbim të banorëve. Dhe të gjitha këto veprime që ne kemi bërë, i kemi bërë për banorët. Patjetër që institucionet respektohen, vendimi i Gjykatës respektohet. Ne s'mund ta shkelim, se është mbi ne Gjykata. Dhe ne kemi zbritur pikë për pikë ç'thotë ajo Gjykatë. Gjykata ka caktuar një firmë, një ekspert që mban përgjegjësi, që ka hedhur firmën, thotë: "Ky pallat përforcohet", dhe kostoja del më e ulët se 70%, dhe ne sot kemi ardhur me thënë që ky është vendimi, dhe ky vendim është marrë. Nuk kemi dy rrugë të tjera, është marrë ky vendim. Dhe e vetmja gjë, me mirëkuptim, do ishte që një minutë më parë, bashkë me kërkesën për pozicionin numër dy, t'i çohet Qeverisë kërkesa përfundimtare për buxhet, që të bëhet përforsimi total (nga themelet, nga dritaret, nga të gjitha) dhe të fillojë puna, dhe mos të

shtyhet më gjatë. Çdo shtyrje thjesht shtyn kohën e atyre banorëve që presin. Kjo është, me pak fjalë, një përmbledhje e asaj. Okej, këto janë divergjenca dhe banorët jemi më shumë se...

Sefedin Lika (Këshilltar): Unë të kuptoj, por në qoftë se këto nuk duan me riparuar pallatin e vet...

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Shiko, banorët nuk janë ekspertë, inxhinierë të fushës. Me gjithë respektin, banorët janë banorët tanë, janë vëllezërit tanë, motrat tona, kushërinjtë tanë. Por kjo s'do të thotë që ata janë inxhinierë, as unë s'jam inxhinier. Është një studio me licencë që është kontraktuar dhe është paguar, por me marrë përgjegjësi, dhe ata mbajnë përgjegjësi sot edhe mbas 100 vjetësh, sepse ato firma që janë hedhur, depozitohen në arkiv, depozitohen në Gjykatë.

Sefedin Lika (Këshilltar): Gjithsesi unë do votoj pro banorëve.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Fjalën e ka Ded Ndreca.

Ded Ndreca (Këshilltar): Këtu problemi është: Për ato inxhinierët që kanë marrë parasysh atë punë, duhet ta shohim mirë, ta vlerësojmë mirë, se asnjëri nga ne nuk është inxhinier, është ekspert për këtë punë. Se na ndodh si në Thumanë që hynë njerëzit brenda dhe pat viktima. Po që se ju e shihni që duhet të futen njerëzit brenda, të futen. Kështu që gjithë këshilltarët, nuk mendoj se ka një këshilltar që është kundër njerëzve për t'i ndihmuar, si të jetë më e mira, e kupton? Edhe Bashkia duhet të konsultohet me inxhinierët, duhet ta vlerësojë mirë atë punë.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Ato inxhinierë e mbajnë përgjegjësi penale ligjore.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Faleminderit. Zoti Pashk Prenga e ka fjalën.

Pashk Prenga (Këshilltar): Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Faleminderit, zonja kryetare. Realisht. Ky problem mendoj që duhet trajtuar me shumë logjikë dhe pa ndonjë ekuivok ndaj njëri-tjetrit, jo se kush e ka fajin. Deri tani. Unë kam qenë pjesë e Këshillit të parë dhe e kemi miratuar që, sipas një studimi të Institutit të Ndërtimit, ky pallat duhet të priset. Tani, paska dalë një vendim gjykatë që mos me u prish. Kur del një vendim gjykatë, zoti nënkryetar i Bashkisë...

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Jo, vendimi i Gjykatës është mos me u prish.

Pashk Prenga (Këshilltar): Pse ne e sjellim në Këshill kur ka dalë një vendim gjykatë? Pse vjen në Këshill?

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Është procedurë ligjore që do t'i kalojnë të gjitha fondet e rindërtimit në Këshill. Pra, ky vendim duhet të merret nga Këshilli. Ky vendim definitiv duhet të merret nga Këshilli.

Pashk Prenga (Këshilltar): Duhet të kalojë në Këshill. Okej, dakord. Tani. Shkresa e dytë e Institutit të Ndërtimit... Shkresën e parë e kam miratuar me shumë dëshirë që ky pallat me u prish. Kjo shkresë, shkresa e dytë, po e Institutit të Ndërtimit... Mu unë nuk e kuptoj se aty paska

para, ta kuptojmë. Mërzitem me njëri-tjetrin, marrë marrë nga një institucioni, nuk e kuptoj se si funksionon puna. Ky paska dalë me një material tjetër që e ka qenë Gjykatë, që ky pallat nuk duhet me u prish. Pallati kur kemi marrë vendimin, ne ka qenë në vitin 2018; sot jemi në 2025, 7 vjet. Që sa dëmtimin e të bëjmë të tjera, 7 vjet që kanë kaluar, 7 vjet. Kur Instituti ka konstatuar me u prish në 2018, ne në 2025 do të thojmë që të rregullohet, ky pallat të investohet, e të riparohet pallati. Tani, ky vendim i ka ardhur në Bashki në muajin maj të vitit 2025. Shkresa për rikonstrukcion pallati. Sot jemi në muajin tetor. Pse kjo vonesë?

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Po t'shtyjë, Urbanistika ka punët e veta që do t'i marrin, do t'i shqyrtojë, do t'i analizojë, patjetër të gjitha shkresat që vijnë për Urbanistikën në Bashki duhen konsultuar.

Pashk Prenga (Këshilltar): Se mu më duket kjo vonesa, më duket pak absurde, ta kuptojmë. Të vijë materiali në muajin maj 2025, të paraqitet në Këshill në fund të tetorit 2025.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Materiali analizohet nga Urbanistika, analizohet nga grupi i Urbanistikës.

Pashk Prenga (Këshilltar): Përderisa e ka analizuar Instituti i Ndërtimit, s'ka pasur ç'analizonte Urbanistika.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Se duhet parë a e kanë sjellë të plotë, apo nuk e kanë sjellë të plotë.

Pashk Prenga (Këshilltar): Okej, dakord. Tani. Unë nuk jam specialist i ndërtimit. Për ironi të fatit, nuk e njoh këtë fushë. Aty shoh shumë banorë që kanë ardhur. Edhe propozimi im është: Përderisa ne presim nga muaji maj, deri në fund të tetorit, ta shtyjmë edhe këtë muaj, deri në fund të nëntorit. Dhe banorët të dalin, jo ato që janë, po të gjithë banorët të më dalin me një deklaratë të përbashkët, janë dakord që pallati të riparohet apo jo? Një. E dyta, aty si mes banorëve janë dy njësi tregtare. Këtyre dy njërive tregtare nuk është prishur pallati për shkak të këtyre dy njërive, është prishur për shkak të meritës. Pra, këto dy njësi të njëjtën sipërfaqe... Të njëjtën sipërfaqe e ndërtimit. Që ky pallat të njëjtën sipërfaqe e ndërtimit. Se ato kanë investuar koncialet aty për me investuar. Pra, për shkak të këtyre konfuzioneve që kemi sot, mbledhja do të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe mbledhja në radhë vjen me një material më konkret. Lidhur me deklaratën e banorëve, një, edhe me vendimin e tash... Administrata e Bashkisë ta sqarojë mirë problemin me biznesin. Se ne si këshilltarë nuk kemi kurrë në botë me prishur punë këtyre dy bizneseve.

Shpetim Çoba (Banor): Faleminderit dhe ju kërkoi ndjesë nëse fola pa leje përpara. Por unë mendoj se si ky pallat ka pasur shumë pallate në Laç që ju është bërë rikonstrukcion dhe banorët kanë hyrë në shtëpitë e tyre. Ju bëj me dije se jo të gjithë banorët kërkojnë shembjen e këtij pallati. Ka të tjerë që kërkojnë përforcim, ashtu si jam edhe unë që kam biznes në atë pallat. Nuk e di Bashkia i ka keqinformuar qytetarët, sorollat për këtë pallat për arsye votash. Unë bie dakord edhe nëse shembet, por a më kthen Bashkia biznesin që unë kam në atë pallat diku tjetër, ose aty? Dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Faleminderit.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Secili e mban vetë përgjegjësinë se si flet. Absolutisht nuk është ashtu. Nuk është. Në këtë rast nuk besoj absolutisht se është punë votash. Në këtë rast është jeta e njerëzve në rrezik.

Shpetim Çoba (Banor): Jeta e njerëzve në rrezik... Kemi dhe pallate të tjera që janë bërë rikonstruksion.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Okej, pra në këtë rast po flitet për pallatin 84. Vetëm tani. Vetëm tani që s'ka lidhje votash, mendoj. Faleminderit. Altin Bruka e ka fjalën.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Faleminderit kryetare. Vetëm një përgjigje, një fjali, vetëm një fjali kam. Vetëm një fjali jam kundërshtim meqë the. Që Bashkia i ka sorollatur. Bashkia nuk i ka sorollatur asnjëherë banorët, i kemi pritur. Unë personalisht i kam pritur disa herë edhe i kam shpjeguar, dhe banorët të gjithë ja ku janë këtu. Edhe të gjithë janë për, por ka një procedurë gjykatë.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Ju lutem. O zotëri. Kur të vijë radha me fol do flasësh prapë. Altin Bruka.

Altin Bruka (Këshilltar): Faleminderit, faleminderit kryetare. Unë kisha dy pyetje për inxhinierin. Njërin nga pyetjet u rezervua nga kolegu. Mundem? Kryetare, mundem?

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): E po të lutem tashti, të lutem. Të lutem. O zotëri, tashti kur të jetë mbledhja... Zotëri, kur të jetë rasti, mbledhja me kërkuar llogari për pallatet e tjera, jam krejt dakord. Sot po flitet për një gjë konkrete, për një pallat konkret, për një vendim konkret. Të lutem mos dalim nga tema. Altin Bruka.

Altin Bruka (Këshilltar): Faleminderit. Njëra ndër pyetjet që duhet të bëhej nga kolegu im për përforcimin, ishte strukturor, themelor apo material. Sipas projektit të përforcimit thuhet që nuk ka kaluar shumë mbi 70%. Pyetja ime është kjo për inxhinierin: Nëse gjatë kohës tejkalohet kjo shumë mbi 70%, çfarë do të ndodhë? Do të ndërpritet apo do të kalojë në rindërtim? Faleminderit.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Atëherë projekti është i detajuar në të gjitha elementet e tij dhe nuk ka parashikuar asnjë fond rezervë për këtë. Është e rezervuar kjo vlerë. Është finale.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Si, si? Çfarë është kjo?

Altin Bruka (Këshilltar): Domethënë nëse kalohet mbi 70%, çfarë do të ndodhë? Kjo ishte pyetja. Do të kalohet në rindërtim apo do të vazhdohet sërish me rikonstruksion?

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Jo, projekti nuk... Në momentin që merret vendimi, nuk kalon më për rindërtim, për prishje, për fillim nga e para. Atëherë ky, nëse varet si merret vendimi... Atëherë, projekti i ka të gjitha detajet, i ka kaluar edhe oponencën teknike, i ka parë të gjitha zërat, me librezë masash e me tërë elementët që e shoqërojnë dhe nuk ka asnjë hapësirë për të pasur problematikë të tillë. Nuk ka në... domethënë, nëse është një objekt i ri, mund të ketë një

problem. Kur është përforcimi, kur i ka kaluar të gjitha hallkat me projektet nga A-ja tek Z-ja, të gjitha nuk lënë hapësirë për problematikë. Për shembull, ata marrin si shembull: po u prishën tulla më shumë... Materialet që do të zëvendësojnë ato, janë shumë më cilësore se ato që janë. Por edhe me këto tulla që janë, janë bërë analiza dhe ajo tulla po të jetë aty e prepur se e prepur, nuk do të ishte problem. Pra, nëse u dëmtua tulla, plasariti, a ku di unë, e kanë goditur në një mënyrë tjetër, do zëvendësohet me një material shumë më të fortë se ai si është. Kështu që s'ka ndonjë [problem].

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Anton Kolziu.

Anton Kolziu (Këshilltar): Faleminderit, zonja kryetare. Me sa shihet, këtu janë dy palë të interesuara për atë pallat. Ju si Bashki nuk keni gjetur një gjuhë të përbashkët me interesat e këtyre të dy palëve që të jeni ulur dhe të keni biseduar me to për t'i dhënë zgjidhje, ndoshta dhe pa shkuar në Gjykatë?

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Shumë e rëndësishme. Ky rasti ka tejkaluar këto mundësi. Kanë kaluar në Gjykatë. Në momentin që kalon në Gjykatë, çdo lloj institucioni tjetër duhet të flasë.

Anton Kolziu (Këshilltar): Pa shkuar në Gjykatë? Sepse këto palë janë të interesuara që ta dinë që është marrë vendim.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Është marrë vendim pa shkuar në Gjykatë për ta prishur. Pastaj ka kaluar në Gjykatë dhe ka pezulluar. E ka tejkaluar.

Albert Ndoci (Këshilltar): Po. Jurist je në profesion?

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Inxhinier i ndërtimit.

Albert Ndoci (Këshilltar): Kjo është pyetje për juristë, po ja. Në rastin po marr fundit, u miratua. Banorët, që mund të ketë ndonjë banor të pakënaqur kundër këtij vendimi, a ka të drejtë me bërë ankimim prapë? A ka të drejtë? Më fal. Të shihni, sikur është kundërshtuar vendimi i Këshillit Bashkiak që ka lënë, edhe ky vendim kundërshtohet. Kështu do të ikin edhe shtatë vjet të tjera. Siç kanë ikur edhe shtatë vjet të tjera. Se kushdo nga banorët ka të drejtën e Zotit të ankohet.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Kjo është shumë e drejtë. Në këtë rast të gjithë dalin të humbur, domethënë të gjitha palët, sepse nuk shfrytëzohen siç duhet.

Albert Ndoci (Këshilltar): Prandaj duhet të marrim një vendim që të jetë në interes të të gjitha palëve. Unë jam dakord me të gjithë ato. Të gjithë shqiptarët që janë për zgjidhje të këtij problemi. Po ja, një banor do të ankohet, prapë do shkojë edhe shtatë vjet. Nuk është zgjidhja ky vendim që mund të marrim ne sot. Se ju jeni të na lëni atë tokën këtu, sikur krejt fajtorë janë ata të Këshillit Bashkiak.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Jo, jo. Atëherë vendimi i Gjykatës, ecuria që ka ardhur deri tani, e bën të vetmen të mundshme që vendimi i Këshillit të bëhet për me kërkuar fondet. Nuk ka zgjidhje tjetër përveçse me kërkuar fondet. Kjo është ideja se Këshilli... Këshilli.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Të lutem, o zotëri. O zotëri, të lutem. Tashti duhet të dëgjoj edhe banorët. A ka dikush që do me fol? Jo. Të lutem. Banorë, okej.

Olsi Gjoka (Banor): Për sa i përket kësaj pike, ne çdo kundërshtim... Kuptoj, e kam thënë këtë mbrëmje. Se ne e lëmë këto biseda të rrugës. Do të ishte marrë një vendim qysh e kemi bërë. Duhet të zgjidhet për të gjithë. Unë mund të bashkohem, e lëmë vend sot, pritet data 26 në vlerë e tregojmë sot. Unë kam bërë... Bashkia. Kam bërë. Ka zgjidhur. Atëherë zgjidhet pa presje. Unë kam bërë.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): A do me fol dikush tjetër nga banorët? Po.

Banore e Pallatit: Aty kam dy pjesëtarë të familjes time. Dy kunatë e dy vëllezër që janë të vetmit me këto ujë, i kam gjetur vetë pjesëtarë. Njëri e ka pasur konstruktor, njëri operon një samuraj. Hëna jo s'mund të jetë brenda. Të tjerë kanë. Në atë pallat kam dy pjesëtarë të familjes time, kunati dhe kunata ime. Por që ata janë pa mundësi me ardhur dhe për arsye shëndetësore dhe të largësisë. Njëri e ka pasur rikonstruktuar plotësisht dhe në rikonstrukcion, me gjithë mobilimin, ka shkuar 30 milionë lekë. Jo luks, mobiljet më të thjeshta, që i dimë të gjithë. Dhe në qoftë se ekspertët e Gjykatës që kanë vendosur shenjat e pallatit janë më të fuqishëm se ekspertët e Institutit të Ndërtimit... Ata e dinë ato që e kanë vendosur. Se ato janë akademikë, Instituti i Ndërtimit janë akademikë, janë profesorë që nxjerrin inxhinierët tonë. Dhe tani del për ankesën e tre-katër personave, del që të jetojmë ne në ato gërmadha që ka 60 vjet. Që e fundit jam unë që i kam hequr ato mobilim shtëpish. Nuk di, kam thënë: "O Zot, të dalim shëndoshë." Kur kam hequr kazanin nga soleta, kam hyrë vetë, kam thënë: "O Zot, a do zbresim sot?" Kam hipur me po ose jo me prekë xhamin me dorë. Dhe ajo, ajo vlera e tij që e nxjerrin me 70%, me cilat çmime e kanë nxjerrë me 70%, se nuk më mbushët mendja kurrë. Të gjithë kemi parë të bëhen shtëpia duke u rikonstruktuar. Unë për veten time kam parë të bëhet shtëpi nga themeli, kam parë të bëhet rikonstrukcion nga themeli. Edhe më rezulton se projekti i një pallati në Laç është bërë me çmimet e manualit të çmimit 2015. Mbase dhe këto kanë bërë me 2015, kur një kuintal çimento bënte 550 lekë të reja, ose një kile hekuri 136 lekë të vjetra, edhe sot është një kuintal çimento 18 mijë lekë të vjetra dhe një kile hekuri 1360 lekë. Mendoni ju? Një metër mobilje ishte, një mobilje që dikur ka bërë një milion e gjysmë, sot bën 3 milionë. Mund të më vijë keq. Se unë kam shtëpinë time që ka qenë DS4 dhe vetëm unë dola, vetëm unë i hoqa mobiljet. Është bërë rikonstrukcion, po absolutisht aty është ka 5 vjet, 6 vjet që futet çmimi u vu dhe më është thënë që është përfunduar. Më vjen keq, kam pasur bërë dhe shkresë... Meqë se unë kam marrë prapë, e kam bërë dhe shkresë Këshillit Bashkiak, patëm një përgjigje me na gënjyer, jo me na thënë të vërtetën. Dhe si, si, si qenka ajo? 45 mijë lekë tre plus një, sa është vlera e një apartamenti? Le të na thotë ajo zotnia që e ka bërë. Po, faleminderit. Lëj pjesët e përbashkëta, se kjo shtëpia e kunatës time është e ngritur. Jo pllakat, por është ngritur dyshemeja, paneli që është vënë aty. Është ngritur.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Ky projekt ka pasur problematika të tilla për çmimet që kanë qenë shumë elastike, pandemia, e tjerë e tjerë, por sot. Fatmirësisht jemi duke punuar me

çmimet të miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave që të jenë të vitit të fundit. Kështu që nuk ka problematika të tilla. Dikur ka pasur, ka të drejtë për qasjen.

Sefedin Lika (Këshilltar): Ajo, ndoshta nuk më kuptoi mua. Unë faktikisht shkoj, edhe që kur janë banorët, i pyeta a jeni pro shembjes apo kundër? Ai e dha mendimin e vet. Tashti ne jemi anëtarë të Këshillit. Ne jemi në opozitë, në radhë të dytë jemi anëtarë të Këshillit të ri. Edhe mu më ndodh që më parë pak atë ditë, edhe nuk kam ditur gjë. Sa për dijeni, ë? Sa për informacion? Ne duhet t'i mirëkuptojmë të gjithë ata që janë aty, se janë hall. Të na sqarojnë, po gjithsesi ka të drejtë ai, se nuk më njeh, as e di se jam anëtar këshilli. Se normalisht edhe ju maxhorancës duhet të na jepni të drejtë të na njohin.

Diogjen Kolici (Këshilltar): Instituti i Ndërtimit a e ka pranuar dhe a ka folur me të njëjtën gjuhë me projektin e bërë nga firma, apo e ka kundërshtuar projektin që ka bërë firma?

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Atëherë, bëhet oponencë teknike për projektin në tërësi. Bëhet oponencë teknike tek Instituti i Projektimit dhe... A bëhet oponenca teknike? Projekti i Ndërtimit nuk ka gjetur vërejtje për të ndryshuar në projektin e propozuar nga studioja e projektimit, e cila rastësisht qëlloi që të jetë dhe profesoreshë e asaj shkolle. Okej.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Tashti, a ka pyetje tjetër, diskutim tjetër para se ta hedhim në... Të lutem, o zotëri. Po të dëgjoj më shumë se ti, nuk e dëgjon tjetër kush këtu.

Shpetim Çoba (Banor): Jemi në Shqipëri, në rast të njëjtë. Po i bëj dy pyetje të gjitha. A ka ndodhur ndonjëherë në rast të njëjtë në Shqipëri, siç është, ne po hedhim vetëm dy njerëz që po interesohen për këtë pallatin, të jetë ndërtimi i parë që ka bërë nga Bashkia? A kupton? Edhe mos të bëhen, ose të bëhet ai që unë po vazhdoj me... me raste për me analizë të thelluar, edhe nuk e bën këtë punë vetëm me vendosjen e letrave. Dakord? Kur erdhi analiza e kësaj dhune, që neve e çuam nga Gjykata, por të dyja palët... Neve nuk kemi ende të drejtë të shkruajmë që, domethënë, në qoftë se ky pallat neve si njësi do na japë një njësi që ne kemi, shpjegoja anëtarëve të Këshillit.

Altin Marashi (Inxhinier Urbanistike): Atëherë, kjo është politikë strehimi, nuk ka lidhje fare me ashtu. Mund të kesh pas... Të zhdëmtuar, duhet strehuar, s'ka lidhje.

Shpetim Çoba (Banor): E kuptuam që ky pallat është që mos bëhet rikonstruksion, sepse nuk kundërshtojmë me e bërë rikonstruksion, është që mos bëhet rikonstruksion. Pse ju si Këshill nuk ndiheni që ajo zonë të jetë zonë për ndërtimin e qytetit, për rrugën, zhvillim? Po çelësi, pallati të hyjë si komision. A jemi dy njerëz ne si banorë edhe jemi dakord? Jemi dakord me analizën e pallatit tash stabil, ashtu kemi bërë.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Albert, Albert, lutem. Lutem. Lutem. Çfarë mund t'i bëj për shembull? Albert, lutem. Lutem. Albert. Albert Ndoci, të lutem. Të lutem, jo me këtë lloj toni, të lutem. Nuk është fare normale. Po, Krenar. Krenar Kasmi e ka fjalën. Ja, ndize.

Krenar Kasmi (Këshilltar): Atëherë unë jam plotësisht dakord me qytetarin. Pse? Përderisa ne kemi tagrin me dalë mbi një vendim gjykate. Jo, jo, përderisa ne na kërkohet me dalë mbi një

vendim gjykate. Na kërkohet, është tjetër gjë, por ne nuk e kemi mbi vendimin e Gjykatës. Ne si Këshill na kërkohet me dalë mbi një vendim gjykate. Ka të drejtë qytetari që ne të dalim mbi këtë që t'i caktojmë pjesën që kërkon ai, edhe të shembet, edhe të bëjë atë dorë. Për biznes, për banim, për çfarë... ta konceptojë ai. Atëherë, pse na kërkohet ne kur s'dalim mbi vendim gjykate? Se po na kërkohet ne këtë, s'po e kuptoj.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Nuk po kërkohet me dalë mbi vendim gjykate. Është miratimi, jo mbi. Miratimi i kësaj. O jo, miratimi. Përderisa...

Krenar Kasmi (Këshilltar): Jam plotësisht dakord edhe me atë. Pse? Përderisa vjen një vendim gjykate dhe Këshilli Bashkiak... Ama është... Pse është e kjo muhabet? Ta ndezë këtë. Në qoftë se doni me e komplikuar, doni me e tjetërsuar si temë. Është puna juaj. Në qoftë se doni me e lexuar projektin.

Rinaldo Piroli (Këshilltar): Sa për sqarim të banorëve, ne nuk kemi fuqi as me shembur e as me ndërtuar. Ne jemi ata për me e miratuar ose mos me e miratuar që ky fond të kalojë. Mbas këtyre zhanrave që ne jemi aty të diskutojmë me ju, ne vendosim mbas këtyre që jemi duke dëgjuar, dhe atëherë që të jetë, nëse do e kalojmë për miratim fondi apo jo. As nuk shembim, as nuk ndërtojmë. As nuk kemi një anë dorë me ju dhënë njerëzve, apo banesë. Vendimi është nga Qeveria.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Patjetër. Jam shumë dakord me Rinaldon, jemi në shkallën e fundit, etapa e fundit. Fati që ka ardhur deri në këtë pikë.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Pa u marrë vendimi i Gjykatës, asnjë projekt nuk është bërë për këtë. Asnjë projekt s'është bërë pa marrë vendimin e Gjykatës. Nuk është bërë, e kupton? Kështu që ju e dini. Çfarë të thotë? Ju e dini.

Pashk Prenga (Këshilltar): Tani, po e shohim se të gjithë kemi të drejtë. Të gjithë kemi të drejtë, të gjithë kemi hall. Në këtë rast, po e shohim konfuzionin që na lë këtu në Këshill. Unë jam me idenë e parë: Ta shtyjme për mbledhjen tjetër. Të sqarohen të gjithë banorët me një deklaratë, të gjithë banorët, të lutem, një sekondë. Ta marrim deri në fund. Të gjithë banorët të dalin me një deklaratë të përbashkët: janë dakord me jetuar në këtë pallat, a s'janë dakord. Një. E dyta, aty si mes banorëve janë dy njësi tregtare. Këtyre dy njësite tregtare nuk është prishur pallati për shkak të këtyre dy njësite, është prishur për shkak të meritës. Pra, këto dy njësi të njëjtën sipërfaqe... Të njëjtën sipërfaqe e ndërtimit. Që ky pallat të njëjtën sipërfaqe e ndërtimit. Se ato kanë investuar konciale aty për me investuar. Pra, për shkak të këtyre konfuzioneve që kemi sot, mbledhja do të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe mbledhja në radhë vjen me një material më konkret. Lidhur me deklaratën e banorëve, një, edhe me vendimin e... Administrata e Bashkisë ta sqarojë mirë problemin me biznesin. Se ne si këshilltarë nuk kemi kurrë në botë me prishur punë këtyre dy bizneseve.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Edhe shefja e Urbanistikës.

Eduart Kurti (Nënkryetar i Bashkisë): Mbledhja është në dorën tuaj, mund ta kaloni dhe për mbledhjen tjetër, se janë ditë. Ama propozimi i Bashkisë është ky, nuk ndryshon dhe i jep zbatim

vendimit të Gjykatës në të. Unë ju them: unë i jap vendimin e Bashkisë. Ti ke propozimin e Bashkisë dhe propozimin e punonjësve. E dëgjojmë dhe sot, e dëgjojmë dhe herën tjetër.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Nënkryetar, ja të flas edhe zonja, shefja e Urbanistikës.

Iris Tahiraj (Drejtoresha e Urbanistikës): Përshëndetje të gjithëve. Atëherë, mbas Ligjeve dhe Akteve Normative në Republikën e Shqipërisë, ne kemi ardhur sot si zyrë me këtë projekt-vendim. Pra, është Akti Normativ Nr. 9, është vendim i Gjykatës dhe ne jemi këtu për të bërë kërkesën, për të propozuar Këshillit Bashkiak për të miratuar këto fonde, për t'u kërkuar Qeverisë Shqiptare për financimin e përforcimit. Këtë nuk mund ta kalojmë me dëshirë, sepse janë inxhinierë të licencuar për këtë punë, që kanë firmosur dhe kanë vulosur këtë projekt. Projekti është i detajuar. Unë dua të sqaroj Diogjenin dhe Pashkun në lidhje me vonesat që kemi ardhur në këtë kohë. Dhe të gjitha këto vonesa kanë ardhur si efekt se dyert dhe dritaret nuk i ka shembur tërmeti. Edhe ne, pra banorëve, kemi kërkuar që i gjithë projekti të jetë i përfshirë me instalime hidraulike, elektrike, sepse ne e dimë amortizimin që ka pësuar objekti dhe godina në këto vite. Dhe në preventiv janë të parashikuara edhe punimet e nevojshme dhe të detyrueshme. Pra, dyert, dritaret, nuk i ka shembur tërmeti. Të lutem, Albert, ta çojmë deri në fund.

Albert Ndoci (Këshilltar): Këtë hyrje ka 30.000 euro ka mbi sipër, jo me përsipër.

Iris Tahiraj (Drejtoresha e Urbanistikës): Patjetër është preventivi. Të lutem, është preventivi i detajuar me të gjitha punimet që do të kryhen. Pra, do të jetë me çelësa në dorë. Thjesht nuk do të shembet.

Iris Tahiraj (Drejtoresha e Urbanistikës) [Vazhdim]: Dyert dritare, të gjitha. Nuk është me dakordësi, o zonjë, të lutem. Është me një projekt, është i firmosur, është i vulosur dhe mban përgjegjësi, të lutem, të lutem. Mban përgjegjësi ligjore për atë që ka firmosur. Tani, me dëshirë, ne këtu nuk merremi, po merremi me ligj. Të lutem, të lutem. Ne merremi me ligj, jo me dëshira, sepse nuk është moment dëshire kjo. Të brenda. Të brenda. Të lutem. Jemi një nga një, sepse s'ju kuptoj asnjë gjë që...

Rinaldo Piroli (Këshilltar): A ta shohim edhe ne projektin, edhe ashtu i bëmë një tjetër?

Sefedin Lika (Këshilltar): Po, kujtojmë, faleminderit një sekondë. Ne po e agravojmë këtë mbledhje vetëm në kohë, për asgjë gjë. Të shihni. Pashë kufirin e qartë, ka qenë edhe anëtar i këshillit. Në herën tjetër. Ai është më. Ai është më i saktë. Ne jemi thashë edhe herë tash, parin e natës, nuk e dimë informacionin tamam. Tash dy herën tjetër, edhe bisedojmë nëse janë të këshillit me qytetarët. Mos. Se po agravohen edhe qytetarët.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Unë jam shumë dakord me Pashkun, që të marrim dhe ne kohë, po mendoj se ky është vendim gjykatë. Edhe vendimi i gjykatës, prapë se prapë... E njëjta gjë është. Po, patjetër. Patjetër, patjetër. Po është bërë një projekt që do të bëjë përforsim dhe do të kuptohet fondi në qeveri. Është dhe... Pra, pa miratim.

Laurin Sana (Këshilltar): Faleminderit, zonja kryetare. Pyetja ime. Pyetja ime, sepse na bëhet një kontraditë e logjikshme pjesës së vendimit të gjykatës në formën e prerë dhe ardhja këtu në këshill. Gjithmonë, çfarë ndodh nëse kjo nuk votohet? Nuk votohet këtë herë, nuk votohet herën tjetër, nuk kalon si projekt-list. Çfarë ndodh në fund të fundit? Si shkon procedura? Ma shpjego, atëherë... Sepse momentin që ju na vini me një lloj formë presioni që kjo ka marrë si punë, për çfarë do votojmë ne? S'e kuptoj.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Atëherë e hedhim në votim. Kush është prapë, kush është prapë me miratimin e fundit për rikonstrukcion për pallatin 84? Pra. Arbër... Pra, kush është kundër? Kundër? Kundër? Kush është kundër? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë.

Ded Ndreca (Këshilltar): Duhet të sqarohen mirë këto gjëra me administratën e bashkisë, se bashkia është përgjegjëse numër një për këtë punë. Me qytetarët. Ne s'dimë gjë a është.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Tash votojmë, mos votoni. Tani, sa janë abstenimet? Po votua, keq? Abstenim, sa janë? Një, dy. Tre abstenim. Tre abstenim. Arbër. Arbër, të lutem. Votat?

Rezultati i Votimit (Për dy projekt-vendimet për Pallatin 84, lagjia 3 Laç)

- 1. Projekt-vendim për miratimin e një ndryshimi në V.K.B. nr. 63, datë 22.04.2020, për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave pronë publike dhe pronë private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në akt-ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.***
- 2. Projekt-vendim për miratimin e përforcimit dhe ndërhyrjeve të nevojshme të pallatit nr: 84, lagje nr: 3 Laç të prekur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në projektin e përforcimit, opionencë teknike dhe shkresën e ardhur nga Instituti i Ndërtimit.***

Nuk miratohen me:

- 5 vota pro***
- 4 vota abstenim***
- 9 vota kundër***
- Nuk votuan fare: 4 këshilltarë.***

Rinaldo Piroli (Këshilltar): Arbër, na e sill bashkë me projektin, nëse këto kanë mundësi, na e sill muajin tjetër bashkë me projektin, nëse këto kanë mundësi. Ju lutem, nis e bë projektin. Kujtoj, unë kam një mendim. Tani. Kalojmë te pika dy. Përfaqësues këshilltarësh, pra, pesë gjashtë këshilltarëve, të gjithë kësaj bashkisë, të jepemi projektin, të jepemi problemet e qytetarëve, atëherë unë votoj.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Tashti, ky është një zgjidhje, atij pallati do t'i jepet. Një zgjidhje, atij pallati do t'i jepet, sepse ai nuk do të rrijë ashtu. Fakti që ne nuk kaluam fondin e rikonstrukcionit.

Pashk Prenga (Këshilltar): Në mbledhjen tjetër, mos ta shtyjme më. Po. Tani, të shpjegoj pse vota ime është kundër sot. Kjo është **kundër provizore**. Votë kundër provizore. Pra, në mbledhjen tjetër, të jetë me një material ballafaques, me secilën palë. Bashkia të vijë me një material ballafaques, dhe banorët e banorëve të tjerë dhe këtyre të tjerëve të dalin me **një deklaratë të përbashkët**, ta dorëzojnë në sekretarin e Këshillit të Bashkisë. Një deklaratë të përbashkët, janë apo s'janë dakord me rikonstruksionin, një, dhe administrata e bashkisë të vijë me një material se si do veprojnë me biznesin. Ta analizojmë muajin tjetër dhe të japim zgjidhje definitive muajin tjetër, mbledhjen e radhës.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Në rregull. Atëherë. Atëherë. Mbledhjen tjetër jemi prapë të hapur për ta diskutuar. Nuk e di, si do të mblidhet një komision i posaçëm. Jam dakord me propozimin e Dedës edhe të Pashkut, të mblidhet një **Grup nga anëtarët e Këshillit** në bashkëpunim me Bashkinë, me banorët, ta rrjedhë në një marrëveshje, sepse kjo është një çështje që nuk do lihet kështu. Banorët janë pa shtëpi, është gjëja më normale në botë që t'i jepet një zgjidhje. Dhe diçka, për njësitë e biznesit, unë mendoj, si anëtar i Këshillit, si Kryetar i Këshillit, t'i jepet një zgjidhje njërive të biznesit, që edhe banorët e tjerë që i kanë për banim, mos të ngelen peng i atyre njërive të biznesit. Besoj, edhe banorët tani e dinë. Atëherë ju si qytetarë duhet ta bini dakord. Me të njëjtën gjë që ne si këshill mund të bëjmë, është kjo: të bëhet një e përbashkët me anëtarë këshilli, me Bashkinë, me banorët. Atëherë kalojmë te pika tjetër. Banorët janë të lirë. Banorët mund të largohen, faleminderit.

Pika 3+4: Projekt-vendime për Mbështetje Financiare nga Fondi i Emergjencave

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave për dëmet e shkaktuara në banesë nga plasja e bombës së gazit, familja Tafili, njësia administrative Milot, fshati Shulaz. Kush është pro? Kush është kundër? Miratohet.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Familja Gjergji, njësia administrative Laç, Sanxhak. Pra, kush është pro? Kundër? Miratohet.

Rezultati i Votimit për Projekt-vendimet e Emergjencave Civile

Miratohen të dy projektet e emergjencave civile:

- 1. Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave për dëmet e shkaktuara në banesë nga plasja e bombulës të gazit, familja Tafili, njësia administrative Milot, fshati Shullaz.*
- 2. Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave për dëmet e shkaktuara në murin mbajtës afër banesës, familja Gjergji, njësia administrative Laç - Sanxhak.*

Vota Pro: 22, Vota Kundër: 0, Abstenim: 0; Rezultati i votimit: Miratohet me 22 vota pro.

Pika 5: Projekt-vendim për Miratimin e Tarifave të Ujit të Pijshëm dhe Ujërave të Ndotura

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Projekt-vendim për miratimin, ju lutem, për miratimin e tarifave të ujit të pijshëm, grumbullimin e largimit të ujërave të ndotura. Çfarë është kjo?

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Studimisht, është vendimi që merret nga asambleja e Lezhës, asambleja që janë tre bashkitë, dhe është lënë që për këtë vit **mos të ketë ndryshim, as rritje, as ulje të çmimit të ujit**. Thjesht po. Atëherë ky vendim është propozim për lënie në fuqi të tarifave që janë. Pra, nuk ka as rritje, as ulje të çmimit për këtë vitin 2023. Tarifa.

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Tashti, për nivelin e përmirësimit të tarifës së ujit të pijshëm, grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura, bazuar në shkresën 842/2, numër protokollit datë 9/10/2025. Drejtoria e ujësjellësit kanalizimeve Lezhë ka kërkuar një mendim për nivelin e tarifimit të ri... dhe ju kemi sjellë paraprakisht këtë projekt vendim për vendim dhe shqyrtim nga ana e Këshillit Bashkiak. ...Kemi një kërkesë për ndihmë për nivelin e tarifuar të shoqërisë renale ujësjellësit kanalizimeve Lezhë dhe ju kemi bashkangjitur një tabelë mbrapa të kuotat e shërbimeve... Jam dakord që herë tjetër ju keni votuar kundër, domethënë kur...

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Po, po, unë e di që ju s'keni lidhje, po domethënë është më u tall me ne. Ne themi jo, ato thonë po, ato thonë jo.

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Zonja kryetare, unë jam i detyruar pas ligjit ta sjell.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Okej. Po edhe këtë radhë jam e bindur që do dalë një gjë tjetër, gjithsesi kush ka pyetje?

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Domethënë, drejtor, ta qartësojmë fiks, **për vitin 2026 nuk do ketë rritje**.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Në rregull. Mos ketë rritje. Kush ka pyetje? Anton.

Pashk Prenga (Këshilltar): Pra që ta sqarojmë, për vitin 2026 nuk do ketë rritje? Nuk është me 1050 lekë, siç thashë më vonë thjesht për korrigjim. Ke lexuar për Lezhën, është njësi e Lezhës. Njësia e Kurbinit është tabela dy, domethënë që ke tarifën.

Anton Kolziu (Këshilltar): Kur e kemi votuar kundër, ka qenë çmimi 550 lekë të vjetra, tani është 650 lekë të vjetra.

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Kurbini e ka tabela e dytë 450 lekë klienti familjar.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Mos i sillni më fare, sepse në fund fare bëhet sikur duan ata. Kjo është ideja. A e solle, ishte null vendimi jonë, mos e bie më. Për çfarë e bie, domethënë? E bie që jemi tu u tall me këshillin, kot me kot. Tashti, e hedhim votim. Ka kush pyetje tjetër? **Hedhim votim që mos të rritet asnjë, asnjë tarifë.** Kush është pro? Bë që mos të rritet asnjë tarifë. Kush është kundër?

Rezultati i Votimit për Tarifat e Ujit

Projekt-vendimi Miratimi i tarifave (pa rritje) Vota Pro 21, Vota Kundër 0, Abstenim 1

Vendimi: Miratohet Projekt-vendim për miratimin e tarifave të ujit të pijshëm, grumbullimin e largimin të ujërave të ndotura (duke i lënë në fuqi tarifat aktuale).

Pika 6: Projekt-vendim për Miratimin e Listës së Familjeve që Përfitojnë Subvencionimin e Kredisë

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Projekt-vendim për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025. Urdhëro.

Erisa Gjoni (Këshilltare): Ne do jemi ata që do na i sjellim prapë parafaktit kryer. Projekt vendim për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025.

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Tani kemi ca kuota që na ka sjellë Qeveria **mbi 17 kreditë buta për Bashkinë Kurbin**. Edhe ne si komision... e kemi mbështetur ligjin 22/18 për strehim social. Nga këto ka pasur 88 aplikime. Gjithsej 38 kanë kërkuar të përfitojnë nga subvencioni i kredisë dhe vetëm shtatë, jo më fal, **tetë janë, janë miratuar** nga Komisioni, tetë familje për këto kredi. ...Ka familje që janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni... Ka familje që janë skualifikuar për të ardhura shumë të larta dhe nuk hyn në programin e kredisë së butë. Edhe ka familje që janë skualifikuar dhe për të ardhura shumë të ulëta që nuk mund ta përfitojnë.

Diogjen Kolici (Këshilltar): Faleminderit zonja kryetare. Atëherë nga 17 kuota kanë përfituar vetëm tetë. **Çfarë supozohet të ndodhë me nëntë kuotat e tjera** të cilat buxheti...

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Do ripërsëriten vitin tjetër prapë si rritje. Vitin tjetër. Pra nuk ka shtyrje afati... Ajo është një, një, një që hapet nga Ministria si tjetër edhe jemi të detyruar që vetëm kur të caktojë a do, a do domethënë të aplikojmë ne për këto.

Diogjen Kolici (Këshilltar): Domethënë bashkia jonë ka çuar dëm nëntë kuota që nuk janë përmbushur.

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Nuk i kemi çuar dëm, nuk i ka përfituar kush zoti këshilltar. Nuk kanë shkuar dëm, nuk janë përfituar këto trashëgohen. S'janë përfituar se s'kanë plotësuar kriteret, s'kanë plotësuar dokumentet.

(Diskutimi vazhdon për kriteret, transparencën dhe procedurën e ankimit.)

Erisa Gjoni (Këshilltare): Është një ngërç tjetër. Banka kërkon gjë tjetër, bashkia kërkon gjë tjetër. Ky është një ngërç që prek banorët. Si do të zgjidhet kjo punë?

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Bashkia mbas pikave të VKM-së. E shpjegoj... Të gjithë familjet përfituese kanë të ardhura 70.000 lekë të reja dhe lart. Pra, me këto të ardhura automatikisht banka i miraton kredinë...

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): ...Nga komisioni të posaçëm kemi zgjedhur këto tetë familjet sepse plotësojnë kriteret që janë vënë... **Brenda pesë ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga këshilli bashkiak kanë të drejtë ankimi...**

Pashk Prenga (Këshilltar): Këto personat që kanë kërkuar me qenë përfitues të këtyre subvencioneve, a janë me status pastaj që janë miratuar në Këshillin e Bashkisë... apo janë qytetarë që kanë paraqitur vetëm kërkesën në Bashki?

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Nuk ka më domethënë e shes me ligj që merr miratim këshill për të dhënien e statusit të pastrehë. ...Në momentin që zoti Pashk Prenga paraqet që unë s'kam pronë, ai automatikisht kualifikohet si i pastrehë.

Pashk Prenga (Këshilltar): ...Ky materiali për mua do të ishte pak më i kompletuar... **Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë qytetari? Cilat janë kriteret që plotësojnë këto qytetarë që kanë përfituar?** Se të jemi transparent me ato që kanë fituar a kupton?

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): Nuk e kam bërë për arsye të drejtë. Ankimimi brenda pesë ditëve çdo qytetar që nuk është në këtë listë... kam provuar vetëm përfituesit, listën e përfituesve. Në qoftë se Pashk Prenga nuk është përfitues ka të drejtë domethënë brenda 50 vjet bë ankimimin me shkrim te zyra ime...

Pashk Prenga (Këshilltar): Dhe një kërkesë shumë miqësore... Këshilltarëve nuk është mirë me i thënë kush nga administratat që **hajde shife te zyra materialin...**

Rudolf Toma (Drejtori i Shërbimeve): I ke miratuar ti kriteret herët më parëshme se kush janë ato. ...Unë ta thashë ose bëje bëje bëje edhe me shkrim që se ashtu keni ankesë dhe mund ta kthej me përgjigje me shkrim.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Tjetër? Nuk ka pyetje tjetër. E hedhim votë.

Rezultati i Votimit për Subvencionimin e Kredisë

Vota Pro 22 Vota Kundër 0 Abstenim 0

Vendimi: Miratohet Projekt-vendim për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025 (me 22 vota pro).

Të Ndryshmet (Informacioni Financiar dhe Propozimet)

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Tek të ndryshmet kemi **informacionin e kërkuar nga Laurin Sana dhe Anton Këlziu në lidhje me veprimtarinë financiare**. Nënkryetar, ti mos na ik. Pastaj është Aida dhe në fund Diogjeni.

Laurin Sana (Këshilltar): Faleminderit zonja kryetare. Atëherë unë kam dhe një shqetësim mbi pjesën e kërkesave. Unë jam këtu si këshilltar edhe mendoj se zëri im do të dëgjohet edhe pa kërkesa me shkrim siç më është bërë si formë debati që duhet me bërë kërkesa me shkrim për të marrë informacione. Atëherë mbas asaj respektova, kam bërë **tre kërkesa me shkrim** për këtë muaj dhe mua **nuk më është kthyer asnjë kthim përgjigje** domethënë. Edhe çfarë më mbetet mua dhe shumë mbetet përsëri që nënkryetarët ose kushdo qoftë këtu t'ia bëj prapë pyetjet me gojë. Pyetja e parë është pse nuk më është kthyer përgjigjja. Atëherë pyetjet/kërkesat me shkrim i kam këtu të protokolluara domethënë lidhur me **investimet e tërmetit 2019** që është nga çështjet më kryesore problematike.

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Sepse tërmeti ka shumë brenda saqë duhet një muaj me t'i shpjeguar, me marrë letrat se është arritur këtu.

Laurin Sana (Këshilltar): Ore e du të përgjithshme, e du të përgjithshme. Kërkesa tjetër lidhet me **buxhetin e vitit 2025** sepse po afrohem për miratuar buxhetin e vitit 2026. Kur do ketë një statistikë për vitin 2025 të buxhetit 2025.

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Për pyetje specifike edhe unë do të kthej përgjigje jashtë. Për lidhje me investimet ose në zë që ke.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Po pra, po realizimi me investim jepi një datë se kur do të jepet. Në mbledhjen e ardhshme, në mbledhje e ardhshme me realizim investimesh/shpenzim.

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Qysh sot, ok. Kam informacion të përgjithshëm e kam në bazë kërkesë. Po shumë mirë, ja sot unë kam një kërkesë nga ana juaj, me datë 17.10. Dhe do t'ju përgjigjem sipas pyetjeve që është.

Rake Kola (Shefe e Financës): Përgjigjet e kërkesave të këshilltarëve. ...Unë po bëj një panoramë përgjithshme në bazë për burimet dhe për shpenzimet.

- **Buxheti 2025 i miratuar:**
 - **Burimet Totale:** 995,096,081 lekë.
 - **Shpenzimet (ndarja kryesore):** Paga dhe Sigurime Sociale (498.5 milion + 83.1 milion), Shpenzime të Përgjithshme (267.3 milion), Fondi Rezervë (3.5 milion), Fondi i Emergjencës (8.5 milion), Investime/Projekte (79.7 milion), Investime/Punime (124.2 milion).
- **Zbatimi i Buxhetit (Janar – Shtator 2025):**
 - **Të ardhurat nga taksat/tatimet:** Realizuar në masën **50%** të planifikimit (87.7 milion lekë).
 - **Të ardhurat nga Transfertat (Qeveria Qendrore):** Realizuar në masën **100%**.

- **Shpenzimet e Realizuara:** Paga (69%), Sigurime Sociale (68%), Shpenzimet e Përgjithshme (29%), Fondi Rezervë (86%), Investime Projekte (100%), Investime Punime (62%).
- **Ndryshimet Buxhetore:** Janë bërë vetëm dy ndryshime me Vendime të Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2025.
- **Projektbuxheti 2026-2028:** Jemi në fazën e tretë (finale), do të kalojë përmes dëgjësave publike dhe miratimit në Këshill.
- **Buxheti i Këshillit Bashkiak (Përgjigje për Anton Këlziu):**
 - **Pagesa për Këshilltarët:** 9.672.000 lekë (10% e pagës së titullarit).
 - **Pagesa për Kryetarët e Fshatrave:** 4.260.000 lekë.
 - **Shpenzime Aktivitete/Trajnime:** 700.000 lekë.
 - **Shpenzimet e realizuara:** Është bërë pagesë e rregullt e këshilltarëve dhe sekretarit. **Nuk është bërë akoma asnjë lloj transaksioni për 700.000 lekët e parashikuar për aktivitete dhe trajnime.**

Anton Kolziu (Këshilltar): Unë dua të di fondin për pajisjen e sallës me mikroфона. Sa është fondi që janë shpenzuar për pajisjen e sallës me mikroфона?

Rake Kola (Shefe e Financës): 10 milionë lekë që janë akorduar për pajisjen e sallës së Këshillit me mikroфона **janë shpenzuar.**

Anton Kolziu (Këshilltar): Por kemi bërë një kërkesë dhe unë nuk mora asnjë përgjigje për fondet e Këshillit se ku kanë shkuar.

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): ...Buxheti është 700 mijë lekë, 7 milionë të vjetra. Buxheti është tjetra, një mikrofon është lënë për gjithë vitin. Ju s'keni sjellë faturë as vjet, as sivjet. Këto lekë nuk mund të shpenzohen si pasie. Këto bëhen për një trajnim, për një shkëmbim eksperience, për një plan për rritjen e kapaciteteve.

Anton Kolziu (Këshilltar): Sa është shpenzuar për blerjen e mikrofonave në sallë e Këshillit?

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Që ta japë shefja e Financës po. ...Mbledhjen e radhës do të. Do ta sqarojmë.

Aida Skeja (Këshilltare): A mundem Kryetare, faleminderit. Vetëm një sqarim desha lidhur me atë kërkesën që keni depozituar te Ministria e Shëndetësisë për hapjen e dy qendrave shëndetësore, atë të Fushës së Milotit edhe Sanxhakut. A keni ndonjë përgjigje se kur do të?

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Po. Është bërë kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë për pajisjen me mjetet e nevojshme dhe **po presim vetëm pajisjen me aparaturat**, sepse ne kemi bërë vetëm rikonstruksionin dhe aparaturat do i sjellë Ministria sepse janë detyrë e saj.

Diogjen Kolici (Këshilltar): Faleminderit zonja kryetare. Unë do të doja të diskutoja për një politikë ekonomike që besoj do të ishte shumë e vlefshme në rastin e bashkisë tonë. Unë mendoj që mund të ndajmë një zë në buxhet... për të bërë **subvencionimin e gjysmës së një rroge për**

bizneset që punësojnë të rinj (18 deri në 30 apo 35 vjeç). Gjysma e rrogës së këtij individi që punësohet të paguhet nga bashkia.

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): A keni bërë një preventiv sa shkon për shembull atë? Atë duhet të rakordohemi me bashkinë.

Diogjen Kolici (Këshilltar): Unë mendoj që sikur me **3 milionë lekësh të reja** besoj se mund të arrihet që për 10 biznese të subvencionohet gjysma e rrogës për një periudhë gjashtë mujore.

Eduart Kurti (N/Kryetari i Bashkisë): Si ide është shumë e mirë, patjetër që nuk është ide e keqe, por nuk është një ide e re. ...Duhet të shikojmë **hapësirat ligjore** që na lejojnë ne që t'i kanalizojmë fondet aty. Ligji 139 (Neni 28) i jep funksione bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, dhënien e granteve financiare... Por si të jetë e zbatueshme.

Mbyllja e Mbledhjes

Edlira Lleshi (Kryetare e Këshillit): Deklaroj mbylljen e mbledhjes Laç 03.11.2025.

Sekretari i Këshillit:
Arbër LEKA